

Data 26.08.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërhyrje në infrastrukturën turistike të aventurës, Zip line, ura të varura, Via ferrata, parqe aventure, etj: Zip Line në Kullën 360° në Divjakë, në liqenin e Roshnikut, Berat, në liqenin e qytetit të Belshit, në Eco Park Dumrea, Belsh, në liqenin e Funarit, Elbasan, në liq. e Gjelbër, Lalëz, Durrës, në Valbonë, Bajram Curri, në Voskopojë, Korçë dhe Via Ferrata në fshatin Buronja, Kuç, në bashkinë e Vlorës dhe në kanionin e plazhit të Gjipese”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT: 166,640,575.11 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 22AA601.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurrohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e cila perfshin kategorite e meposhtme.

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

NP-1 A:	Punime gërmimi në tokë
NP-2 B:	Ndërtime civile dhe industriale
NP-3 A:	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
NP-4 A:	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP-7 A:	Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
NP-11 A:	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

NS-3 A:	Impiante ngritëse dhe transportuese
NS-8 C:	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
NS-18 A:	Punime gjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. A	Punime gërmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> Germim dheu me ekskavator zingjir, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim ne mjet Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Germim dheu me ekskavator zingjir, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim ne mjet (bloqet e ankorimit). Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km Germim dheu me ekskavator zingjir, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim ne mjet Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Germim dheu me ekskavator zingjir, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim ne mjet Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km 	0-20 mln leke	1,080,733 leke
N.P- 2 B	Ndertime civile dhe industriale.	<ul style="list-style-type: none"> Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel. Shtrese zhavor lumi t=20cm Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (themelet e platformës dhe bloqet e ankorimit) 	21-50 mln leke	34,848,805 leke

		<ul style="list-style-type: none"> • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C • Mbushje me cakell pas mureve • Ndërtimi i ndërtesave në pikat e nisjes dhe mbërritjes ku përfshihen punimet strukturore, hidraulike, elektrike, mekanike dhe të rifiniturave • Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit). • Shtrese zhavor lumi t=20cm (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit). • Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit). • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit) • Mbushje me cakell pas mureve • Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel. • Shtrese zhavor lumi t=20cm • Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (themelet e platformës dhe bllloqet e ankorimit) • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C • Mbushje me cakell pas mureve • Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel. • Shtrese zhavor lumi t=20cm • Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (themelet e platformës dhe bllloqet e ankorimit) • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C • Mbushje me cakell pas mureve • Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel. • Shtrese zhavor lumi t=20cm • Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (themelet e platformave dhe bllloqet e ankorimit) • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C • Mbushje me cakell pas mureve • Ndërtimi i ndërtesave në pikat e nisjes dhe mbërritjes ku përfshihen punimet strukturore, hidraulike, elektrike, mekanike dhe të rifiniturave • Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit). • Shtrese zhavor lumi t=20cm (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit). • Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit). • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C (Platforma ne mbërritje dhe bllloqet e ankorimit) • Mbushje me cakell pas mureve • Ndërtimi i ndërtesave ne pikat e nisjes dhe mbërritjes ku 		
--	--	---	--	--

		<p>perfshihen punimet strukturore, hidraulike, elektrike, mekanike dhe te rifiniturave (kati i dyte perfshin vetem strukturen dhe parmacet metalike)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel. • Shtrese zhavor lumi t=20cm • Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (themelet e kullave dhe blloqet e ankorimit) • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C • Mbushje me cakell pas mureve • Ndërtimi i ndërtesave në pikat e nisjes dhe mbërritjes ku përfshihen punimet strukturore, hidraulike, elektrike, mekanike dhe të rifiniturave • Struktura monolite betoni C 12/15 për shtresa nën themel (Platforma ne mbërritje dhe blloqet e ankorimit). • Shtrese zhavor lumi t=20cm (Platforma ne mbërritje dhe blloqet e ankorimit). • Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (Platforma ne mbërritje dhe blloqet e ankorimit). • F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm për beton B500C (Platforma ne mbërritje dhe blloqet e ankorimit) • Mbushje me cakell pas mureve 			
NP-3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	<ul style="list-style-type: none"> • Revitalizim dhe përshtatje e platformës për Zipline (struktura ndihmëse, parmacë dhe lyerje me bojë) • Revitalizim dhe përshtatje e platformës për Zipline (struktura ndihmëse, parmacë dhe lyerje me bojë) 	0-20 leke	mln	2,000,000 leke
N.P-4 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	<ul style="list-style-type: none"> • Ruge aksesi, sistemim sheshi dhe vendparkime të cilat përfshijnë gjërmim dheu, mbushje me material të përshtatshëm, shtresë cakulli 20cm, shtresë stabilizanti 15cm, dhe struktura të vogla b/a. • Ruge aksesi, sistemim sheshi dhe vendparkime të cilat përfshijnë gjërmim dheu, mbushje me material të përshtatshëm, shtresë cakulli 20cm, shtresë stabilizanti 15cm, dhe struktura të vogla b/a. • Ruge aksesi, sistemim sheshi dhe vendparkime të cilat përfshijnë gjërmim dheu, mbushje me material të përshtatshëm, shtresë cakulli 20cm, shtresë stabilizanti 15cm, dhe struktura të vogla b/a. • Ruge aksesi, sistemim sheshi dhe vendparkime të cilat përfshijnë gjërmim dheu, mbushje me material të përshtatshëm, shtresë cakulli 20cm, shtresë stabilizanti 15cm, dhe struktura të vogla b/a. 	0-20 leke	mln	16,978,062 leke
N.P-7 A	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	<ul style="list-style-type: none"> • F.V. Linje furnizimi me ujë në kullën e nisjes që përfshin tubin PE DN 25mm, PN16, gjërmimin e dheut dhe shtresën e rërës • F.V. Linje furnizimi me ujë në kullën e nisjes që përfshin tubin PE DN 25mm, PN16, gjërmimin e dheut dhe shtresën e rërës • 	0-20 leke	mln	2,440,264 leke

N.P-11 A	Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	<ul style="list-style-type: none"> • F.V. Furnizim me energji elektrike në kullën e nisjes 1F nga OSHEE me linje ajrore ABC Ø25mm² dhe shtylla betoni centrifugale NM-9 m. • F.V. Furnizim me energji elektrike në kullën e nisjes 1F nga OSHEE me linje ajrore ABC Ø25mm² dhe shtylla betoni centrifugale NM-9 m. • 	0-20 mln leke	16,166,249 leke
N.S-3. A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë levizëse, transportues)	<ul style="list-style-type: none"> • Vinc me elektromotor për ngritjen e pajisjeve të Zipline në katin e platformes plus kavo min 50m • Vinc me elektromotor për ngritjen e pajisjeve të Zipline në katin e platformes plus kavo min 50m 	0-20 mln leke	36,000 leke
N.S-8. C	Ndërtim parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	<ul style="list-style-type: none"> - F V konstruksione metalike të perbera (plaforma në mbërritje dhe përshtatja e kullës) - Trajtimi me zink i konstruksioneve metalike (elementet kryesor të ankorimit) - F.V - parapet metalik - Shtrese dërrasa FM 4.0cm - F.V - Kavo çeliku e galvanizuar - F.V - Aksesoret e Zip line dhe Zip Stop - Set pajisjesh për fluturim F.V. Vetratë e jashtme alumini - F. V. Urë druri për të ishulli gjerësia 2m dhe lartësi min. 0.5 m mbi nivelin e ujit - F V konstruksione metalike të perbera (kulla dhe plaforma e mbërritjes) - Trajtimi me zink i konstruksioneve metalike (kulla dhe element kryesor i platformes) - F.V - parapet metalik - Shtrese dërrasa FM 2.5 cm - Shtrese dërrasa FM 4.0cm - F.V - Kavo çeliku e galvanizuar - F.V - Aksesoret e Zip Line dhe Zip Stop - Set pajisjesh për fluturim - F V konstruksione metalike të perbera (plaforma në mbërritje dhe përshtatja e kullës) - Trajtimi me zink i konstruksioneve metalike (kulla dhe element kryesor i platformes) - F.V - parapet metalik - Shtrese dërrasa FM 4.0cm - F.V - Kavo çeliku e galvanizuar - F.V - Aksesoret e Zip line dhe Zip Stop - Set pajisjesh për fluturim - F V konstruksione metalike të perbera (plaforma në mbërritje dhe përshtatja e kullës) - Trajtimi me zink i konstruksioneve metalike (kulla dhe element kryesor i platformes) - F.V - parapet metalik - Shtrese dërrasa FM 4.0cm - F.V - Kavo çeliku e galvanizuar - F.V - Aksesoret e Zip line dhe Zip Stop - Set pajisjesh për fluturim 	51-100 mln leke	65,219,939 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Sistem për ngjitje me litar - Via Ferrata në Fshatin Buronja, Kuç, në Bashkinë e Vlorës - Via Ferrata në kanionin e plazhit të Gjipes 		
N.S-18. A	Punime topogjeodezi ke.	<ul style="list-style-type: none"> - Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik 	0-20 mln leke	

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar, si më poshtë:

- 3 (tre) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profilin Gjeoteknik
- 2 (dy) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e **personelit kryesor** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektiv në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi i stafit kryesor:

Inxhinier Ndërtimi	Inxhinieri i ndërtimit nevojitet për organizimin e kantierit të ndërtimit, për ndjekjen në tërësi të punimeve dhe bën koordinimin e të gjithë personelit teknik në objekt për mbarëvajtjen e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe grafikut të parashikuar në kontratë. (Referuar zërave të punimeve të preventivit)
Inxhinier Ndërtimime profilin Gjeoteknik	Inxhinieri i ndërtimit me profilin Gjeoteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve të zbatimit në formacione shkëmbore të komponentëve përbërëse të projektit të Via Ferrata. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mekanik	Inxhinieri mekanik nevojitet për ndjekjen e punimeve të zbatimit të instalimit të kavove të Zip Line-ve dhe elementeve përbërëse të saj si dhe të punimeve të tjera mekanike si HVAC etj. në ndërtesat pjesë të projektit. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).

Inxhinier Elektrik	Inxhinieri elektrik nevojitet për ndjekjen e punimeve të zbatimit të projektit elektrik në ndërtesat pjesë të projektit të Zip Line-ve dhe Via Ferrata-ve. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinjer Gjeodet	Inxhinieri gjeodet nevojitet për piketimin fillestar të objektit dhe piketimin në vazhdimësi të të gjithë punimeve sipas proceseve të punës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mjedisi	Inxhinieri i mjedisit nevojitet për ndjekjen e punimeve të gërmimit për ndërtimin e urave me qëllim ruajtjen e gjelbërimit (bimësisë së ulet dhe të pyllit) në dy anët e urave, ruajtjen e ambjentit gjatë kryerjes së punimeve; përcaktimin/selektimin e pikës së depozitimit së hedhurinave dhe materialeve të dalta nga gërmimi. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Hidroteknik	Inxhinjeri Hidroteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve për ndërtimin e linjes së furnizimit me ujë në kullën e nisjes që përfshin tubin PE DN 25mm, PN16 si dhe linjes së furnizimit me ujë në kullën e nisjes që përfshin tubin PE DN 25mm, PN16, gërmimin e dheut dhe shtresën e rërës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).

2.3.3 Operatori ose bashkimi i Operatorëve duhet të ketë minimumi një staf mbështetës për projektimin me kualifikimin dhe eksperiencën e mëposhtme:

Menaxher Projekti/Inxhinier Ndërtimi
Arkitekt
Inxhinier Strukturist
Inxhinier Mekanik
Inxhinier Elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.4 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e **personelit kryesor** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevojat për stafin mbështetës lind si rezultat i tipit të kontrates me çelës në dorë, ku nevojitet paraprakisht dhe projektimi.

2.3.4 Stafi i projektimit duhet të zotërojë licencat e mëposhtme:

- Kat 2.a: Projektim arkitekt – Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike
- Kat 2.b: Projektim arkitekt – Projektim: 1. Objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara
- Kat. 3.a: Projektues konstruktor – Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
- Kat. 3.b Projektues konstruktor –Projektim: 2. objekte me skelet metalik
- Kat. 3.d Projektues konstruktor – Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike
- Kat. 4.a Projektues instalator – Projektim të instalimeve hidro-termosanitare
- Kat 4.b Projektues instalator – Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi
- Kat 4.c Projektues instalator – Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale
- Kat 4.f Projektues instalator – Projektim të sistemeve kundra zjarrit
- Kat 4.h Projektues instalator – Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës për përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza III-VI).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projektime të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i kategorive dhe klasifikimit të licencave bazohet në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Në kuptim të dispozitave në fuqi për licencimin profesional në projektim dhe në plotësim të kushteve që detyrat specifike në një

shoqëri kryhen nga drejtues teknik të licencuar për ushtrimin e aktiviteteve respektive, kërkohet që dhe stafi profesional të ketë kualifikimet dhe i pajisur me licenca profesionale individuale sipas kualifikimeve dhe fushave të përgjegjësisë që do të mbulojnë. Nisur nga fakti se hartimi i projekteve do të kërkojnë njohuri të plota në fusha të ndryshme të projektimit (në kuptim të dispozitave në fuqi për kontrollin e disiplinimin e punimeve në ndërtim dhe licencimin profesional në fushën përkatëse) gjykohet e domosdoshme që operatorët ekonomik të disponojnë licencë profesionale (si i vetmi dokument që i jep të drejtën për ushtrimin të kësaj veprimtarie) me të paktën kategoritë sipas objektivit të kontratës. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike, termave të referencës, si dhe bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimiti” të ndryshuar dhe VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” ndryshuar me VKM 943/2016. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me përshkrimin e përgjithshëm të detyrës së projektimit, ndërhyrjeve teknike të propozuara, fazave të përshkruara në termat e referencës, si dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet. Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në konsideratë zbatimi i përcaktimive në LPP te ndryshuar, neni 46, pika 1/a, që parashikon se operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe

procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” rekomandohet të jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **30** persona për periudhën, tre mujore nga data e zhvillimit te procdures e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen tre mujor e nga data e zhvillimit të tenderit,
- Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit te punonjësve projektuesi ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratësn. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muaj, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 30 persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike jane bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim).Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, I ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Argumentimi i numrit të punëtorëve:

Total orë pune= 108’000 orë (sipas grafikut të punimeve)

Ore/1 ditë pune= 8 ore

Total Ditë pune puntori= 108’000 orë/8 orë= 13’500 ditë pune

Dite pune gjithesej= 18 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 25 ditë/muaj= 450 ditë pune Numri i

fuqisë puntorë = 13’500 dite pune /450 ditë= 30 puntorë

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi/qira/kontrate furnizimi).

Nr.	Mjeti	Sasia (copë)	Statusi	Proceset e punës
5	Mjete dhe pajisje sigurie për punime në lartësi dhe në zona sipërfaqe shkëmbore (shock absorber, rripa lidhës sigurimi, kokore, etj.)	6	Pronësi ose qira	- Pajisje siguria për punime në lartësi dhe zona të vështira në shkëmbinj
6	Auto vinç minimumi 2 ton	1	Pronësi ose qira	- Montim strukturave prej çeliku
7	Rul ngjeshës minimumi 5 ton	4	Pronësi ose qira	- Ngjeshje e mbushjeve nën themel dhe shesheve
8	Tokmak	4	Pronësi ose qira	- Ngjeshje e shtresave ne zona te ngushta pas mureve
9	Auto-pompë betoni	4	Pronësi, qira ose kontratë me subjekte që prodhojnë beton	- Betonim të strukturës b/a të ndërtesave dhe blloqeve të ankorimit të Zip Line, themeleve etj.
10	Autobetoniere	2	Pronësi, qira ose kontratë me subjekte që prodhojnë beton	- Betonim të strukturës b/a të ndërtesave dhe blloqeve të ankorimit të Zip Line, themeleve etj.
11	Betoniere kantieri	4	Pronësi ose qira	- Betonime në sasi të vogla.
12	Kompresor	2	Pronësi ose qira	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik
13	Gjenerator	2	Pronësi ose qira	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) *Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Argumentimi i mjeteve është si mëposhtë:

Mjetet	Sasia (copë)	
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pesë) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	4	- Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km

Ekskavator me goma minimumi 0.25 m ³	4	- Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim ne mjet - Sistemim skarpatah
Fadromë me goma	4	- Shtrese zhavorri - Mbushje me çakëll dhe sistemim i shesheve
Makineri për hapje vrimash në shkëmb deri në diametër 22mm	6	- Shpim në shkëmb me diametër 22mm për elementet e Via Ferratave.
Mjete dhe pajisje sigurie për punime në lartësi dhe në zona sipërfaqe shkëmbore (shock absorber, rripa lidhës sigurimi, kokore, etj.)	6	- Pajisje siguria për punime në lartësi dhe zona të vështira në shkëmbin
Auto vinç minimumi 2 ton	1	- Montim strukturave prej çeliku
Rul ngjeshës minimumi 5 ton	4	- Ngjeshje e mbushjeve nën themel dhe shesheve
Tokmak	4	- Ngjeshje e shtresave ne zona te ngushta pas mureve
Auto-Pompe betoni	4	- Betonim të strukturës b/a të ndërtesave dhe blloqeve të ankorimit të Zip Line, themeleve etj.
Autobetoniere	2	- Betonim të strukturës b/a të ndërtesave dhe blloqeve të ankorimit të Zip Line, themeleve etj.
Betoniere kantieri	4	- Betonime në sasi të vogla.
Kompresor	2	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik
Gjenerator	2	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik

2.3.9 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve janë pjese e pandare e DST.

Ne cdo rast nese janë përmendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët	65
2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike	pikët	10
3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët	10
4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët	10
5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët	5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 65] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike

[0 –10 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kritere duhet të provojë se zotëron meritat teknike, aftësi organizative, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:

Punime specifike për:

- Punime për ndertimin e Zip Line me gjatësi jo më pak se 1000 m për kontrata të kryera brenda një periudhe 1 vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit 0-8 pikë

- Punime për ndertimin e Via Ferrata me gjatësi jo më pak se 300 m për kontrata të kryera brenda një periudhe 1 vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit 0-2 pikë

Punimet për instalimin e një Zip Line dhe via ferrata kërkojnë aftësi dhe përvojë të specializuara. Stafit i kualifikuar është thelbësor për të siguruar që instalimet janë të sigurta dhe që plotësojnë të gjitha standardet teknike dhe të sigurisë. Përvoja në projekte të ngjashme siguron se ekipi ka njohuritë e nevojshme për të përballuar sfidat specifike që mund të dalin gjatë punimeve.

Punimet specifike, si instalimi i sistemeve të kabllave për Zip Line, kërkojnë njohuri teknike të avancuara dhe përvojë në trajtimin e materialeve të specializuara dhe proceseve të montimit. Një ekip i kualifikuar do të jetë në gjendje të aplikojë praktikën më të mirë të industrisë për të arritur cilësinë e kërkuar.

Një ekip me përvojë në punime të ngjashme si instalimi i kabllave me fije celiku me diametra dhe gjatësi të ndryshme (për zip line), instalimi i pikave të ankorimit sipas tipologjive të ndryshme (për via ferrata), me eksperiencën e nevojshme për realizimin e punimeve në lartësi, do të jetë më i aftë për të zbatuar projektin në kohë dhe me efikasitet të lartë, duke minimizuar rrezikun e vonës, gabimeve apo aksidenteve gjatë realizimit të punimeve që mund të ndodhin për shkak të mungesës së përvojës.

* Ky është kriteri vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjeçar, afat i cili nënkupton një periudhë 24 muajore të pandërprerë gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punimeve dhe volumeve të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit. Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} / V_{\max k2} \times P_{\max k2}$$

P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k2}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)
$P_{\max k2}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$P_{k2} = O_{k2} / V_{\max k2} \times P_{\max k2}$	
P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k2}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k2}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) [0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$P_{k2} = O_{k2} / V_{\max k2} \times P_{\max k2}$	
P_{k4}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k4}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k4}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k4}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) [0 - 5 pikë] (jo më pak se 3 %)

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara).

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se **4,391,046.52** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zërin

Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera. 4,391,046.52 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera. 4,391,046.52 leke pa tvsh do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 4,391,046.52 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} / V_{\max k2} \times P_{\max k2}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia në punime: siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$$\begin{aligned} O & \quad - \text{(pikët e Ofertës)} \\ Mo & \quad - \text{Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme} \\ N & \quad - \text{Numri i ofertave të vlefshme} \\ PR (Rrm) & \quad - \text{Rritje e mundshme} \\ Mo & \quad = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N \\ PR & \quad = 200 \% Mo \end{aligned}$$

Vlera e ofertave të ofruara $> PR$ rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.